



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2020:175281

Datë: 09.08.2021

Numri i dokumentit: 02070989

P.nr.10/2021

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEGA NË GRAQANICË - Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Rustem Begolli, me zyrtarin ligjor Fatmir Gashi, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit S.K, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.5253/2020 dt.08.12.2020, të cilën e përfaqëson Prokurori i Shtetit Arbresha Shala dhe të pandehurit S.K, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 02.08.2021, në prezencën e Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit, me datë 02.08.2021 publikisht shpalli ndërsa u përpilua me datë 09.08.2021, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S.K** nga i ati ..e ëma .. e gjinisë .., i lindur me datën .. në fshatin .., me vendbanim në fshatin .. në rrugën .., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal .., i gjendjes shumë të varfër ekonomike, veteran i UQK-së, i , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 19.10.2020 me rastin e kontrollit të bërë nga ana e personave të autorizuar zyrtar të KEDS-it, në njësinë elektrik me numër 90056326 në shtëpinë e të pandehurit S.K në fshatin .., është konstatuar se i pandehuri pa leje dhe autorizim të furnizuesit të autorizuar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, është furnizuar me energji elektrike duke e bashkuar hyrje daljen në fazën L1 dhe ka shpenzuar energji elektrike jashtë pikës matëse, si dhe me datën 23.10.2020 ka dalja e njësorit e ka vendosur në hyrje që do të thotë se energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me atë rast të dëmtuarës KEDS-it i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 71.60 euro

- **Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së**

Andaj, gjykata, në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 38; 39; 40; 42; 46; 47;48; 49 dhe 69 të KPRK-së dhe neneve 365; 450 dhe 463 të KPPRK-së të akuzuarin:

E G J Y K O N

Të akuzuarin **S.K** i shqipton dënimin me gjobë në shumën prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 46 par. 3, të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku **një (1) ditë** burgim do të llogaritet me **20 (njëzet)**, euro gjobë.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe atë për paushallin gjyqësor ta paguaj shumën prej **20€**, ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që dëmin e shkaktuar në shumë prej 71.60 euro të ja paguaj palës së dëmtuar KEDS-it Distribucioni Prishtinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.5252/2020 dt.08.12.2020, e ka akuzuar të akuzuarin S.K, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë rast, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 02.08.2021 dhe në këtë seancë i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në këtë çështje penale, ku pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën dhe nuk ka nevoj për ndonjë sqarim.

I akuzuari S.K, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se ndjej vetën fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe e pranoj fajësinë për çdo pikë të aktakuzës, duke kërkuar nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë pasi që është person me gjendje tejet të vështirë ekonomike, ku secili dënim monetar do të ja përkeqësonte gjendjen e tij ekonomike edhe ma shumë. Po ashtu është edhe veteran i UQK-së ku gjykatës ja ofron si provë edhe kartelën .

Pas pranimit të fajësisë gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të akuzuarit, lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, dhe atë dënimin e kësaj veprë penale që e parasheh ligji për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së që parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në tri vite, se nuk do të mund ti kundërshtoj provat apo të parashtrij prova në këtë çështje penale, se nuk do mund ta atakoj vendimin e gjykatës lidhur me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por se mund ta atakojnë për shkak të lartësisë mbi dënimin dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë gjykata detyrimisht duhet ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Prokurori i Shtetit, lidhur me deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, deklaroj se pajtona me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që mbetem në tërësi pran aktit akuzues, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe ky pranim i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhshmëri me provat të cilat iu kanë bashkangjitur kësaj aktakuze, andaj, i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Gjyqtari i vetëm gjykues bindet se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pranimit e fajësisë nga i akuzuari e ka pranuar duke u bindur se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, kurse ky pranim i fajësisë është mbështetur edhe në provat tjera, të cilat gjenden në shkresat e lëndës e që e vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet figura në tërësi e veprës penale të cilën e ka kryer i akuzuari, andaj, gjykata mbi këtë bazë ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i akuzuari e ka vlerësuar dhe e ka pranuar.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se ka patur sjellje të mirë gjatë seancës, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, se është i gjendjes së varfër ekonomike, ndërsa rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti, andaj, gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejt dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se në këtë dënim ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimin për kërkesën pasurore juridike, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEGA NË GRAQANICË / Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.10/2021 dt. 09.08.2021

**Zyrtar ligjor
Fatmir Gashi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Rrustem Begolli**

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.